



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.02.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 12.02.2019.
2. Shqyrtimin e projektligjit “Për censin e popullsisë dhe të banesave”.
3. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Musa Ulqini, Sadri Abazi, Eglantina Gjermani dhe Andrea Marto.

Mungojnë:

Të ftuar:

Delina Ibrahimaj - Drejtoreshë e Përgjithshme e INSTAT-it

Alban Çela - Drejtor i Drejtorisë së Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Maldi Dema - Koordinator për Sistemin Kombëtar Statistikor

Ervin Shameti - Drejtor i Drejtorisë së Statistikave Rajonale

Majlinda Nesturi – Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave të Popullsisë në Drejtorinë e Statistikave Sociale.

HAPET MBLEDHJA

Senida Mesi – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Integritetit Europian.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 12.02.2019, i cili ju është dërguar të gjithëve, përfshirë edhe mua, me *email* për ndonjë sugjerim apo ndryshim.

A jeni dakord me procesverbalin?

Miratohet.

Gjithashtu kemi shqyrtimin e projektligjit “Për censin e popullsisë dhe të banesave”.

Të ftuar kemi zonjën Delina Ibrahimaj, drejtoreshë e Përgjithshme e INSTAT-it, së bashku me stafin e saj, zotin Alban Çela, drejtor i Drejtorisë së Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, zotin Maldi Dema, koordinator për Sistemin Kombëtar Statistikor, zotin Ervin Shameti, drejtor i Drejtorisë së Statistikave Rajonale, dhe zonjën Majlinda Nesturi, përgjegjëse e Sektorit të Statistikave të Popullsisë në Drejtorinë e Statistikave Sociale.

Ju lutem, zonja Ibrahimaj, na bëni një prezantim të shkurtër se çfarë keni parashikuar në këtë projektligj. Cilat janë benefitet?

Më pas do të kalojmë në diskutimet e radhës.

Delina Ibrahimaj – Përshëndetje të gjithëve!

E nderuar zonja drejtuese e komisionit,

Të nderuar deputetë,

Projektligji “Për censin e popullsisë dhe banesave” ka për qëllim forcimin e kuadrit ligjor për kryerjen e censit të radhës së popullsisë dhe banesave në vendin tonë. Efektet kryesore të pritshme janë prodhimi i treguesve statistikorë, të cilët mundësojnë një panoramë të përditësuar dhe reale mbi situatën demografiko-sociale në vend.

Projektakti është hartuar duke marrë në konsideratë standardet e reja ndërkombëtare, të vendosura nga Kombet e Bashkuara dhe Eurostat, për censet e ardhshme të popullsisë dhe banesave për arsye të pozicionimit të statusit juridik të INSTAT-it, si institucion publik i pavarur, si dhe për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga institucionet përkatëse lidhur me censet e kaluara.

Detyrimi për paraqitjen e projektligjit lind nga neni 3 i ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, sipas të cilit censi përfshihet në programin e statistikave zyrtare dhe realizimi i tij rregullohet me ligj të veçantë.

Projektligji synon arritjen e objektivave si vijon:

Së pari, prodhimin e statistikave të popullsisë dhe banesave, duke mirëpërcaktuar me ligj:

- a) rolin e INSTAT, si institucioni përgjegjës, për kryerjen e suksesshme të procesit;
- b) rolin mbështetës që luajnë institucionet e ekzekutivit dhe ato të vetëqeverisjes vendore;
- c) rolin e personelit të angazhuar në proceset e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të

të dhënave;

ç) ruajtjen dhe administrimin e informacionit të mbledhur;

d) detyrimet e subjekteve për të dhënë informacionin e kërkuar nëpërmjet pyetësorëve të censit;

dh) detyrimin e personave për të garantuar konfidencialitetin statistikor;

e) Prodhimin e statistikave zyrtare të popullsisë dhe banesave në mënyrë profesionale, shkencore dhe të besueshme.

Së dyti, kryerjen e censit të popullsisë dhe banesave, në përputhje me rekomandimet dhe standardet e reja ndërkombëtare duke:

a) Përcaktuar terminologjitë statistikore në linjë me ato të përdorura nga Eurostat;

b) përmbushur rekomandimet e institucioneve kompetente kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me zhvillimin e censit të ardhshëm të popullsisë dhe banesave, veçanërisht atyre të dala nga Konferenca e Statisticienëve Europianë (CES 2020) për censet e popullsisë dhe banesave.

Së treti, harmonizimin e bazës ligjore me dokumentet e tjera, që rregullojnë veprimtarinë statistikore në vend, duke marrë parasysh:

a) Standardet e reja të përcaktuara në ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”;

b) strategjinë dhe planin për zhvillimin e censit të popullsisë dhe banesave 2020 në Shqipëri;

c) strukturat mbështetëse të vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të legjislacionit për ndarjen administrative dhe territoriale.

Projektligji është hartuar nga INSTAT-i në bashkëpunim me një grup ekspertësh ndërkombëtarë për të siguruar mbështetjen e qeverisë zvicerane dhe Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës, nëpërmjet projektit SALSTAT. Gjithashtu, projektakti ka marrë parasysh opinionet nga

komunikimet e vazhdueshme, tryezat e rumbullakëta dhe *workshopet* me përfaqësuesit e institucioneve publike, grupeve të interesit, medien dhe institucionet ndërkombëtare etj.

Aktualisht, kuadri ligjor për zhvillimin e censit në Republikën e Shqipërisë rregullohet me ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 “Për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij. Megjithatë, me qëllim që të krijohet një ligj me strukturë të harmonizuar, projektligji propozohet të rishikohet në tërësinë e tij, pa prekur në thelb përmbajtjen dhe vazhdimësinë e ruajtjes së standardeve ndërkombëtare për cilësinë statistikore, sipas parashikimeve të ligjit aktual të popullsisë dhe banesave.

Meqenëse Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat, projektligji synon përputhjen pjesërisht me rregulloret nr. 763/2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 “Për censet e popullsisë dhe të banesave”; Rregulloren e Këshillit të Europës nr. 543/2017, datë 22 mars 2017 “Për përcaktimin e rregullave për zbatimin e Rregullores të KE-së nr. 763/2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit për censet e popullsisë dhe banesave për sa u takon specifikimeve teknike të temave dhe nënndarjeve të tyre”.

Përputhshmëria me aktet e lartpërmendura ka të bëjë me terminologjinë dhe përkufizimet statistikore, veçanërisht për sa i takon Rregullores nr. 763/2008, e cila është direktiva bazë për censet në vendet anëtare. Ndërkohë, rregulloret e tjera kanë të bëjnë me detyrimet që kanë vendet anëtare për mënyrën e kryerjes dhe sistemeve të transmetimit të të dhënave nga shteti anëtar tek Eurostat.

Duke ju falënderuar paraprakisht për mbështetjen tuaj, përfitoj nga rasti t’ju shpreh edhe një herë angazhimin e INSTAT-it dhe timin personal për zbatimin e suksesshëm të këtij ushtrimi mjaft kompleks, me qëllim që të krijohet një e mirë publike, e dobishme për politikëbërjen, monitorimin e performancës, kërkimin shkencor dhe çdo njësie tjetër interesi.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit për prezantimin e projektligjit!

Pa humbur kohë, dua t’ia kaloj fjalën zotit Kasneci, më pas kalojmë në pjesën e pyetjeve dhe diskutimeve. Faleminderit!

Dedë Kasneci – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Ashtu siç u theksua nga përfaqësuesja e qeverisë, projektligji “Për censin e popullsisë dhe të banesave” një nga objektivat e tij ka përfarimin me legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian, konkretisht me Rregulloren e BE-së nr. 763/2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit,

datë 9 korrik 2008 “Për censet e popullsisë dhe banesave”, si dhe me rregulloren zbatuese që Komisioni Europian ka nxjerrë në zbatim të kësaj rregulloreje, e cila rregullon disa aspekte lidhur me specifikimet teknike të temave dhe ndarjeve të tyre. Shërbimi ynë e ka analizuar përputhshmërinë e këtij projektligji me legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian. Për një përafrim më korrekt dhe më të saktë kemi paraqitur 4 sugjerime, të cilat, për eficiencë të punës suaj në komision i kemi diskutuar paraprakisht me përfaqësuesit e qeverisë dhe i kemi dakordësuar. Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit!

Dua t’ua jap fjalën kolegëve deputetë për diskutime ose për pyetje.

Arben Kamami – Faleminderit!

Kuvendi i Shqipërisë në vijim të miratimit të “Axhendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm” nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ka miratuar rezolutën për objektivat e “Axhendës për zhvillim të qëndrueshëm” të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Në rezolutën e Kuvendit parashikohet monitorimi i zbatimit të këtyre objektivave dhe për këtë është kërkuar nga Kryetari i Kuvendit që në relacionin e projektligjit për një periudhë transitore, deri në miratimin e rregullores të përfshihen edhe një zë, i cili duhet të paraqesë se cilat nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm synohet të përmirësohet. Duke lexuar relacionin e projektligjit në diskutim, vërehet se një zë i tillë nuk rezulton të jetë i pasqyruar. Më lejoni t’ju pyes: cila është arsyeja, që nuk është përfshirë “Axhenda 2030”? Cilat janë objektivat që ky projektligj kontribuon për të përmirësuar? Në rast se ju nuk keni përgjigje në këtë moment, më lejoni të kërkoj nga ana juaj një përgjigje me shkrim në lidhje me pyetjet që parashtrova.

Kuvendi i Shqipërisë ka detyrim ligjor monitorimin e zbatimit të ligjeve, por duhet të ketë një pikënisje, dhe sikurse edhe ju jeni në dijeni pikënisja për Kuvendin është ligji dhe arsyeja pse është hartuar ky ligj, pra relacioni. Faleminderit!

Senida Mesi – Urdhëroni, zonja Ibrahimaj!

Delina Ibrahimaj - Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.08.2003, elementet që duhet të shoqërojnë relacionin nuk e parashikojnë një detyrim të tillë. Megjithatë, dua t’i siguroj të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë që treguesit, të cilët do të përftohen nga censi i popullsisë dhe banesave, do t’i shërbejnë gjerësisht matjes dhe monitorimit

të objektivave të zhvillimi të qëndrueshëm, pasi janë baza e matjes së indikatorëve për çdo objektiv.

Senida Mesi – Faleminderit!

Faktikisht, është një kërkesë e vazhdueshme e këtij komisioni për vetë rëndësinë që ka “Axhenda 2030 dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm” që elemente të tilla të përfshihen në çdo vendimmarrje dhe çdo monitorim që do të bëjë parlamenti për qeverinë. Kjo është shumë e rëndësime edhe nga ana e Brukselit për procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, si një nga elementet që do të monitorohet dhe do të kërkohet edhe nga Shqipëria, si një vend anëtar që pret fillimin e negociatave për aderimin në Bashkimin Europian.

Për këtë arsye ne do të vazhdojmë ta kërkojmë, me qëllim që një qasje e tillë të gjendet në çdo vendimmarrje të Kuvendit. Sigurisht, në kuadër të monitorimit të punës së qeverisë, të jenë të përfshira edhe 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Kolegë deputetë, a keni ndonjë pyetje apo sugjerim?

Kalojmë në votimin në parim. Pro?Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në lidhje me votimin nen për nen, kemi edhe sugjerimet e zotit Kasneci, nga Drejtoria e Legjislacionit. Për sa kohë kemi edhe dakordësinë e INSTAT-it, kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Andrea Marto – Kam një ndërhyrje për nenin 4. Te pika 2 thuhet: “Pyetësi i censit mund të përmbajë pyetje për grupin etnik, fenë, gjuhën etj”. Unë them ta caktojmë dhe të themi “duhet të përmbajë”, sepse ne kemi një ligj që i njeh minoritetet, pra njohim një numër të caktuar minoritetesh etnike dhe duhet patjetër të ketë një vlerësim të përafërt dhe për numrin e tyre, për shtrirjen e tyre. Kjo do t’i lehtësojë edhe politikën që ka ndër mend të zbatojë shteti shqiptar për minoritetet. Prandaj mund dhe të mos qenë. Prandaj unë them që pyetësi duhet t’i përmbajë edhe këta zëra. Faleminderit!

Senida Mesi – Zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Pyetjen e kam për të njëjtën pikë të nenit 4. Nisur nga eksperiencia e censit të kaluar, ku ishte pikërisht kjo rubrikë dhe kjo temë që krijoi probleme qoftë në interpretim, në mbledhjen e të dhënave, sidomos kur themi “bazohen në deklarin e lirë dhe jo të detyrueshëm”, nisur edhe nga eksperiencia e mirë dhe e keqe e censeve të kaluara, si është menduar që kjo pikë të shmangë dhe të parandalojë të gjitha abuzimet, sepse nga ajo do të bëjmë interpretime për rezultatin e censit? Si i parandalojmë abuzimet, deformimet e informacionit, të cilat nuk na ndihmojnë të bëjmë as politika të mira?

Delina Ibrahimaj – Në përgjigje të pyetjes, së pari, pyetësi i censit është hartuar në bazë të rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara dhe Eurostatit. Rekomandimet për pyetësin janë të ndara në fusha të detyrueshme dhe jo të detyrueshme. Pyetja për minoritetet dhe përkatësitë etnike e fetare nuk është e detyrueshme. Projektligji që ju paraqitet sot, rregullon procesin e kryerjes së censit jo vetëm për këtë herë, por do të jetë një ligj që do të ndiqet edhe në të ardhmen. Ne nuk e dimë nëse do të duhet apo nuk do të duhet të bëhet një pyetje e tillë për minoritetet. Aktualisht, në pyetësin e censit është pyetja për minoritetet dhe për përkatësitë fetare.

Ne kemi zhvilluar 6 tavolina të rrumbullakëta për t’u konsultuar me pyetësin dhe një nga ato ka qenë specifikisht për pyetjet për përkatësitë etnike dhe minoritetet. Një tjetër ka qenë vetëm për përkatësitë fetare. Në tavolinën e rrumbullakët u diskutua gjerë e gjatë për eksperiencën e censit të kaluar dhe si është më e mira të shkojmë këtë herë në census dhe u ra dakord që pyetja për minoritetet dhe për përkatësitë fetare të jetë një pyetje e hapur dhe me vullnet të lirë, për të mos cenuar aktivitetin e censit. Duke qenë se qëllimi kryesor i tij nuk është matja e etnive apo e minoriteteve, por fotografimi i popullsisë rezidente dhe treguesve demografikë e socialë për popullsinë rezidente të vendit, ne gjuquam që lënia fakultative e kësaj pyetjeje do të ndihmojë procesin e censit që ai të mos cenohet, siç ndodhi në vitin 2011. Mospërgjigjja apo përgjigjja e gabuar do të jenë të përjashtuara nga gjrobat, pra janë pyetje totalisht fakultative.

Senida Mesi – Zonja Ibrahimaj, një pyetje për sqarim. Thuhet, edhe me të drejtë, se mund të përmbajë pyetje, përgjigjja e të cilave bazohet në deklarin e lirë dhe të detyrueshëm. Aktualisht ju pranoni se censi i ka pyetje të tilla dhe përgjigjja lihet fakultative, individuale. Si e tillë edhe në terminologji i bie që, të më korrigjojë pastaj zonja Kumbaro, pyetësi do t’i përmbajë pyetjet, por përgjigjet janë fakultative, individuale dhe jo të detyrueshme për individin?

Delina Ibrahimaj – Ne mendojmë se pyetësi i censit do të kalojë në Komisionin Qendror të Censit, pra nuk është subjekt i ligjit, pasi mund të ndryshojë. Qëllimi pse ne nuk deshëm ta përfshijmë në ligj është se mund ta ndryshojmë në të ardhmen. Ai, gjithashtu, do t'i paraqitet Kuvendit në planin vjetor të statistikave zyrtare, i cili dorëzohet çdo fundviti për zbatimin e programit të statistikave zyrtare për vitin pasardhës.

Senida Mesi – Të falënderoj shumë për sqarimin!

Nëse nuk ka më pyetje për nenin 4, kalojmë te neni 5.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Andrea Marto – Këtu thuhet: “Refuzimi për të dhënë informacionin e kërkuar sipas nenit 5 të këtij ligji, dhënia e informacionit të rremë dënohet me gjobë, dhe cakton një masë të gjobës nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë të rinj”. Këtu shpesh mund të ndodhin edhe keqinterpretime për informacion të rremë ose jo. Unë mendoj që një masë e tillë e gjobës është mjaft e lartë. Lejon shtigje për subjektivizëm dhe për individin është shumë e lartë.

Delina Ibrahimaj – Patjetër që gjoba ka mundësi ankimimi, pasi do të ndjekë proceset ligjore. Përveç kësaj, është neni 24 që rregullon ankimimin ndaj sanksionimit për kundërvajtje administrative. Gjoba është vendosur, pasi çdo ligj që të bëhet i detyrueshëm duhet të ketë një masë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka qenë rekomandim të jetë më e lartë. Edhe ligji për statistikat zyrtare në rast të mospërgjigjes, pra të refuzimit të detyrimit për përgjigje ndaj statistikave, ka masa të tilla.

Senida Mesi – Nëse nuk keni ndonjë vërejtje tjetër për nenin 22, e votojmë. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 24. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 26. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi bashkë me ndryshimet përkatës. Kush është dakord në tërësi me miratimin e projektligjit? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju uroj punë të mbarë dhe shumë suksese!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA